16*32 m e cila siguron nje largim me te mire te ujrave te shiut ne lijesine e kohes. Gjithe struktura e celikut do te lyhet me shtrese antindryshk dhe pastaj me boje alkide RAL 9010.
*MBULESA

Mbi strukturen primare te mbuleses montohet struktura sekondare me profil 120x60 mm e cila krijon mundesine e veshjes se catise me shtresat perkatese.

Mbulesa realizohet me:
a-liamarine trapezoidale mbajtese,
b-shtrese termoizoluese 50 mm XPS, me koeficient te dispersitetit termik jo me I madh se U-0.36 W/m2k.
c- membrane hidroizoluese pvc 1.5 mm HP, UVR.
Per depozitimin e benzines dhe naftes jane vendodsur 3 rezervuar cilindrik

Per depozitimin e gazit te legezuar eshte vendosur 1 rezervuar cilindrike horizontale mbitokesore

Furnizimi i rezervuarve me karburant dhe gaz do te behet me anen e autoçisternave qe ngarkohen ne portet e Porto Romanos ne Durres dhe Vlore si dhe ne stacionet hekurudhore.

Per ngarkim/shkarkimin te autocisternave eshte parashikuar pika e tranvazimit te gazit. Brenda depozites vendoset peshore elektronike per autocisternat.

Per ngarkimin e gazit ne autocisterna sherbene pompa dhe kompresori. Per ambalazhimin e gazit ne bombula perdoret nje pompe me kapacitet 55 m^3 /h. Gjithashtu kompresori mund te perdoret edhe per levizjen e gazit nga njera cisterne ne tjetren.

Qarkullimi i lengjeve behet me tubacione celiku pa tegel sipas standartit API-5L te projektuara sipas kushteve te meposhtme:

Presioni projektit 40 bar o Presioni proves 60 bar

- Presioni punes 18 bar o Temperatura e projektit -10 ^{o}c +120 ^{o}c
- Temperatura e punes + 60 ^{o}c

Ne perberje te imjantit eshte sistemi i ujit zjarrfikes i cili perbehet nga:

Dy motopompa diesel dhe nje elektropompe jockei qe sherbejne per furnizimin e sistemit te dushimit te rezervuarve te GLN-se, te pikes se tranvazimit, hidranteve dhe monitoreve

Masat kunder zjarrit dhe aksidentet

Ne projekt jane perfshire ato masa sigurie qe parashikohen ne "Kushtet Teknike dhe Normat e Projektimit per impjantet dhe Instalimet qe sherbejne per transportimin, depozitimin dhe tregtimin e nafes , gazit dhe nenproduktet e tyre", miratuar nga Ministria e Industrise dhe Energjitikes Nr 184 date 05.07.2005

Asidentet e mundshme ne nje pike karburanti mund te jene:

- Shperthim Gazi nqs ka te instaluar pompe per furnizim me gaz auto
- Sherthim Zjarri o Defekte te funksionimit te sistemeve te ndryshme

Simbolet kufizuese ne objekt kur kemi furnizim…



Per parandalimin e shperthimeve te gazit jane marre keto masa

Per parandalimin e shperthimit nga bymimi termik, rezervuaret pajisen me valvola sigurimi me numers dhe seksion te Ilogaritur sipas normave te komunitetit Europian. Tubacionet e fazes se lenget pajisen me valvola sigurimi te linjes te Ilogaritura 1 valvul $^{1}/_{2}$ për çdo 100 1 volum leng .

Per rastet e carjes se tubacioneve, shperthimit te pompave apo tubove te te gomes, dalja e gazit nga rezervuaret bllokohet si ne daljet e fazes se e lenget edhe ne fazen e gazte me ane te valvolave vetbllokuese (valvola fluksi)

Per parandalimin e mbimbushjes, instalohen kontrollues te nivelit me tregtim te panderprere, si dhe manometri i presionit jep sinjal alarmi kur presioni i fazes se gazte kalon kufirin 14 bar Te gjithe ventilat jane te tipit me sfere inoks me mbyllje te shpejte.

Ventilat, tubacionet, flanxhat, valvolat e ndryshme qe vendosen ne tubacionet e gazit jane material i posacem per gazin e lenget dhe me presion pune 40 bar.

Defekte te funksionimit te sistemeve te ndryshme Per sherbime qe ndikojne direkt ne mbajtjen nen kontroll te parametrave te rendesishem, per te rritur sigurine jane projektuar sisteme te dubluara:

- Ne rast nderprerje te furnizimit te energjse elektrike nga jashte , impjanti eshte i pajisur me gjeneratore elektrik diesel me fuqi te mjaftueshme per te mbajtur ne pune normale te gjithe agregatet. Gjithashtu salla e komandes pajiset me invertitor dhe bateri te mjaftueshme per te mbajtur ndricimin e salles se komandes te gjeneratorit dhe te stacionit zjarrfikes.

- Per sigurine me te larte ne rast emergjence pompat zjarrfikese funksionojne te pavarura me motorr diesel

- Ne rast mosfunksionimi të rregullt te valvolave pneumatike te ujit ato mund te komandohen me dore

- Ne rast mosfunksionimi te rregullt te te sistemit te dushimit te rezervuarve dhe autocisternave mund te vihen ne pune topat e ujit dhe hidrantet

- Nderlidhja midis salles se komandes dhe operatorit ne terren behet me radio dhenese marrese te posacme kunder zjarrit, si dhe me foni me altoparlant. Nderlidhja me pytetin dhe ne vecanti me zjarrfikesen behet me linje telefonike dhe me celulare.

4. PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT

Të dhëna të përgjithshme:

Bashkia e Beratit shtrihet në krahinën malore të Shqipërisë jugore dhe pjesërisht në ultësirën perëndimore në të dy anët e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të Lumit Osum, i cili kalon përmes qytetit të Beratit. Shtrirja në këto dy krahina të ndryshme fiziko-gjeografike, ndikon në ndryshueshmërinë e relievit të territorit, të kushteve fiziko-gjeografike nga perëndimi në lindje e nga veriu në jug, e të peizazheve gjeografike. Bashkia Berat kufizohet në veri me Bashkinë Kuçovë, në lindje me Bashkinë e Gramshit, në juglindje me Bashkinë Poliçan e Skrapar, në perëndim me Bashkitë Mallakastër e Fier. Ajo ndodhet në afërsi me zonat ekonomike të Vlorës, Lushnjes dhe Fierit dhe aktualisht gjendet disi e mënjanuar nga akset kryesore lidhëse kombëtare ekzistuese.

Topografia: Bashkia e Beratit ka një reliev përgjithësisht malor e pjesërisht kodrinor. Ajo shtrihet në të dy anët e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të Lumit Osum, i cili e ndan këtë bashki në dy pjesë. Zona ka një ndërtim gjeologjik të thjeshtë, më i rregullt i krahasuar me zonat e tjera. Tipari më karakteristik morfografik i relievit të saj është ndërthurja shumë e rregullt e vargjeve malore me luginat që pasqyrojnë ndërthurjen e strukturave kryesore të krahinës, të antiklinaleve me sinklinalet. Përgjatë luginave të lumenjve ka një reliev me lartësi dhe me pjerrësi më të ulët. Kjo shihet qartë në zonën qendrore të Bashkisë Berat, ku lartësia varion 30m - 478m dhe pjerrësia luhatet nga 019.5%. Në dy pjesët e tjera të territorit kemi elemente të forta malore. Në pjesën perëndimore gjendet Mali i Shpiragut me lartësinë maksimale 1,218 m dhe pjerrësia varion 55-80 %. Në pjesën lindore ndodhet Mali i Tomorrit, maja më e lartë e të cilit është Quka e Partizanit (2,417m).

Klima: Bashkia Berat ka një klimë tipike mesdhetare fushore, e cila karakterizohet nga një dimër i butë e i lagësht dhe verë e nxehtë dhe e thatë. Temperatura mesatare vjetore është 15.9ºC, ku muaji më i ftohtë është Janari (me temperaturën më të ulët mesatare 7.2 ºC) e muaji më i nxehtë është Korriku (temperaturë mesatare 28, 2 °C). Stina e vjeshtës është më e ngrohtë se ajo e pranverës, për shkak të ndikimit të detit, ku erërat depërtojnë lehtë përmes fushës së Myzeqesë në drejtim të qytetit. Amplituda vjetore e temperaturës është 17.5°C. Temperatura absolute më e ulët ka qenë –12, 2 gradë C dhe ajo maksimale 47, 1 gradë C.[2] Reshjet janë të çrregullta. Sasia mesatare vjetore e reshjeve është 928 mm, me sasinë më të madhe të tyre në Tetor-Nëntor. Muaji më i thatë është korriku me mesatare 291mm për periudhën '71-'80 dhe 26mm për periudhën '80-'90.

Hidrografia: Bashkia Berat ka një rrjet të pasur hidrik. Lumi i Osumit përbënë boshtin kryesor të këtij rrjeti i ndjekur nga Përroi i Molishtit dhe përshkon territorin e Bashkisë së Beratit përgjatë 21 km nga pjesa juglindore në Malinar deri në Moravë në veri ku lumi del nga bashkia drejt Urës Vajgurore. Osumi buron në zona të larta dhe sjell me vete të gjithë erozionin e grumbulluar gjatë rrjedhës së tij të sipërme. Nga degët e Osumit mund të përmenden lumi Zagoria me të cilin bashkohet në Uznovë, përroi Gushtavë dhe përroi Lapardha (në anën e djathtë të lumit). Në anën e majtë, lumi Osum merr me vete Lumin Molisht, afër Velabishtit, i cili buron jashtë territorit të bashkisë. Përroi i Molishtit hyn në Bashki në Veleshnjë në jug, përshkon territorin e Bashkisë drejt Gjerevenit dhe bashkohet me Osumin afër "Urës së Re", Berat. Përveç
Osumit, Bashkia ka dhe një numër të madh rezervuarësh të shpërndarë nëpër fshatra. Ndër ta dallohen rezervuari ndërmjet Sinjës dhe Mbolanit, rezervuari i Mbjeshovës në perëndim të Shpiragut, i Mbreshtanit, rezervuari ndërmjet Kamçishtit e Gjerovenit, rezervuari ndërmjet Vodëzës së Sipërme e Qereshnikut, ai i Roshnikut, dhe rezervuari në Perëndim të Qafë Dardhës.

Akuiferet shtrihen në zona me përbërje të ndryshme gjeologjike. Si rrjedhojë, ata kanë kapacitete të ndryshme ujëmbajtëse. [3] Akuiferet përbëjnë burimet kryesore të furnizimit me ujë për popullsinë, industrinë, bujqësinë dhe aktivitetet të tjera ekonomike në territorin e bashkisë së re të Beratit, Kuçovës dhe të bashkive përreth. Akuiferet kanë një shtrirje të gjerë në nënterritorin e bashkisë, edhe pse është e vështirë të përcaktohet me saktësi sipërfaqja e tyre për shkak të studimeve të kryera në nivel rajoni [4] . Akuiferet janë të llojeve të ndryshme. Megjithatë akuiferet *ndërkokrrizore* dhe *me çarje-karst* përbëjnë burimet kryesore ujore për bashkinë.

Burimet natyrore: Në lindje të territorit të Bashkisë së Beratit ndodhet një pjesë e parkut kombëtar të *Tomorrit. Ai ka një shtrirje në dy* qarqe të vendit (Berat dhe Elbasan) me një sipërfaqe 24,723 ha. Parku ka biodiversitet të pasur me endemizma dhe subendemizma. Sipas ARM-së, parku dallohet për larmi të faunës dhe florës falë

lartësive të ndryshme dhe mikroklimave të krijuara. Në park ka edhe zvarranikë, si gjarpërinj e nepërka. Bimësia përfshinë nga shkurret, dushkajat, pyjet e ahut, lisit, rrobullit (në lartësi 1,600 m mbi nivelin e detit), pyje të përziera, pyje të pishës dhe kullotave të cilat shtrihen në kreshtën e malit. Fshatrat dallohen për pyje me bimësi të ndryshme. Pyjet dallohen edhe për një nënpyll të pasur të përbërë kryesisht nga frashri, vadhëza, lajthia, molla e egër, kulumbria, dëllinja e kuqe e rrallë e zezë etj. Një pasuri tjetër natyrore janë dy grumbujt pyjorë, Pylli i Kulajve, Velçan dhe Gështenjat e Mimiasit. Ndër gjeomonumentet përmendim shpellat e Shahinovës dhe Kapinovës, antiklinalin e Beratit, malin e Tomorit dhe antiklinalin e Shpiragut, etj.

Rrëshqitja/rrëzimi i gurëve[5]: Rrëshqitjet e dheut janë një fenomen tejet i përhapur në qarkun e Beratit dhe në bashki. Deri më sot, në rang qarku, janë numëruar rreth 150 rrëshqitje. Bazuar në hartën e zonimit gjeoteknik të Shqipërsëtë marr nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), në pjesën malore të qarkut të Beratit shpatet kanë pjerrësi të madhe, mbi >30˚. Për këtë arsye, në këto shpate është përhapur më së shumti fenomeni i rrëshqitjeve. Në përgjithësi, ky fenomen është më tepër i përhapur në formacionet flishore me dominim argjiloro-alevrolitik, por edhe në formacionet e molasave argjilore, kryesisht në shkëmbinjtë ku ndodh vendosja e shkëmbinjëve më të fortë mbi ato më të butë. Një situatë e tillë ndodh në zonën "Kruja", "Krasta-Cukali" dhe "Mirdita"[6]. Brezi i kodrave Kuci-Cukala-Allambrasi e më në jug është i prekur nga fenomeni i rrëshqitjes si pasojë e procesit të tarracimit, të cilit iu nënshtruan kodrat gjatë viteve '70-'80. Në pjesën fushore kemi rrjedhje në trajtën e laharëve, në kohë shirash të bollshme.

Vatrat e erozionit: Edhe në Berat erozioni ka qenë i pranishëm në të gjithë sipërfaqen e territorit dhe, për fat të keq, vazhdon të mbetet një ndër problematikat kryesore të tokës. Sipas SHGJSH-së[7], në Berat erozioni vihet re kryesisht në zonat me formacion argjilor dhe flishor. Këto zona përfshijnë pothuajse të gjithë territorin e bashkisë me përjashtim të luginave të lumenjve (kryesisht të Osumit). Vatra erozioni në Berat vihen re kryesisht *në të dyja anët e pjesës qendrore të Osumit*, në *pjesën jugore të Shpiragut, në pjesën e poshtme të Tomorrit* (brenda kufirit administrativ të Beratit), por edhe *në pllajat përgjatë përroit të Molishtit*, në lindje të rrjedhës së tij.

Ajri: Sipas ARM-së Berat, në vitin 2016 janë monitoruar gjashtë parametra për të përcaktuar cilësinë e ajrit në qytet (PM_{10}, SO_2, NO_2, O_3, CO dhe benzen)[8]. Monitorimi është bërë nëpërmjet një stacioni të lëvizshëm, i instaluar në brendësi të oborrit të Bashkisë Berat, pranë rrugës kombëtare që lidh Beratin me Skraparin.

Të dhënat e përftuara nga monitorimi tregojnë një përqendrim mbi normat vjetore të BE-së për parametrat PM_{10} dhe NO_2. Sipas të dhënave, PM_{10} arrin vlerën 119.16µg/m^3 nga 40µg/m^3që është standardi i KE-së. E shprehur në përqindje, vlerat e PM_{10} në ajër janë 179% më të larta se norma mesatare vjetore e BE-së, ndërsa NO_2 arrin vlerën 41.63 µg/m^3 ose 4% më të lartë se norma vjetore e BE-së.

Pyjet, peizazhi, zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti: Bashkia Berat ka në pronësi të saj 5,288.85ha sipërfaqe pyjore dhe kullosore, pa zonat e mbrojtura. Sipërfaqen më të madhe e zë ajo pyjore me 2,827.99ha të sipërfaqes totale e ndjekur nga sipërfaqet inproduktive me 937.00ha dhe sipërfaqet bimore dhe pyjore me vlera të përafërta (371.24ha dhe 387.85ha përkatësisht). Interes paraqesin dhe sipërfaqet kullosore, me një sipërfaqe prej 537,10 ha.

Në territorin e Bashkisë Berat peizazhi ndahet në pesë fasha (tipologji) kryesore: ***urbane, industriale, rurale, natyrore*** dhe ***ujore.***

Territori i bashkisë së Beratit ka një reliev të larmishëm me fusha, lugina dhe kodra e male të larta (mali i Tomorrit). Ky reliev ka ndikuar në formimin e mikroklimave të ndryshme, të cilat kanë krijuar mundësinë për zhvillimin e një flore e faune të shumëllojshme. Bashkia Berat ka vetëm malin e Tomorrit të shpallur si zonë të mbrojtur të kategorisë II, park kombëtar. Megjithatë, bashkia Berat ka 10 monumente natyre që klasifikohen si zona të mbrojtura të kategorisë III.

Për fat të keq, nuk njihet numri total i specieve floristike dhe faunistike dhe habitatet e tyre në territorin e bashkisë. Megjithatë, njihet përafërsisht numri i specieve në rrezik zhdukjeje (Libri i Kuq i Florës Shqiptare, 2006), i cili arrin në 99 specie. Të tilla mund të përmendim salepin krahinor (*Orchis Provincialis*), kokoçelin e Pindit *(Centaurea Pindicola),* çajin e egër *(Origanum Vulgare*) etj.

Përdorimi i Tokës Nga dixhitalizimi i kryer në kuadër të përgatitjes së PPV-së rezulton se nga 380km^2 që është sipërfaqja totale e bashkisë Berat, 170km^2 është tokë bujqësore (këtu përfshihen tokat e kultivuara dhe jo të kultivuara) dhe 180km^2 është tokë natyrore (pyje, kullota). Bashkia Berat përshkohet nga lumi i Osumit dhe është tepër e pasur me ujëra nëntokësore e burime ujore sipërfaqësore. Sipërfaqja totale ujore zë 9km^2. Industria dhe ekonomia shtrihen në një sipërfaqe prej 1.34km^2, ndërsa sipëfaqja që zënë shërbimet është 0.07km^2. Institucionet, shëndetësia dhe arsimi zënë një sipërfaqe prej 0.21km^2 dhe janë të përqendruara në qytetin e Beratit dhe fshatrat kryesore të katër njësive. Banimi shtrihet në një sipërfaqe të vogël krahasuar me tokën bujqësore dhe natyrore, 4.63km^2 . Ndërsa qyteti i Beratit karakterizohet nga zona urbane të konsoliduara, në njësitë e tjera zonat e banuara janë të vendosura përgjatë akseve rrugore. Në total, bashkia Berat ka 812km rrugë, pavarësisht kategorive.

Figura 3. Perdorimi i tokës



5 - IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMII NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT ZBUTESE PER MINIMIZIMIN E TYRE

5.1 Hyrje

Ky raport hartohet mbi bazen e parimit te mbrojtjes se mjedisit dhe ne funksion te institucioneve vendim-marrese per licensimin ose jo te aktiviteteve te ndryshme te cilat mund te kene ndikim ne mjedis. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme veprimtarite te cilat zhvilohen duke pasur parasysh parimet baze te mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimet e mbrojtjes se mjedisit
- Parimi i zhvillimit te qendrueshem
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes se burimeve natyrore
- Parimi i zevendesimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes se integruar
- Parimi i pergjegjesise se ndersjelle dhe bashkepunimit
- Parimi "Ndotesi paguan"
- Parimi i se drejtes per informim dhe i pjesemarrjes se publikut
- Parimi i nxitjes se veprimtarive per mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrotjen e integruar te perberesve te mjedisit nga ndotja, si vegmas, ashtu dhe ne kombinim, duke pasur parasysh nderveprimet ndermjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

- Mbrojtja e Perbersve te mjedisit klasifikohet ne:
- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujerave
- Mbrojtja e tokes
- Mbrojtja e natyres
- Ndryshimet klimatike

5.2. Menyra e menaxhimit te mbetjeve inerte qe gjenerohen nga ndertimi

- Mbetjet e ngurta nga punimet e ndertimit do te jene ne sasi shume te vogel, duke qene se pjesa dermuse e punimeve jane me konstruksione metalike dhe kjo natyre pune e zhvilluar gjeneron pak mbetje ndersa për sa i perket mbetjeve të tjera të gjeneruar ne punimet e sheshit dhe ato te germimit te dheut per groposjen e tankerave (cisternave) jane menaxhuar ne bashkepunim me perfaqesues te Njesise se Qeverisjes Vendore, vendgrumbullimeve te akorduara nga keta te fundit,bazuar edhe ne **VKM Nr. 575, date 24.06.2015, ''Per menaxhimin e mbetjeve inerte''.** Keto mbetje do te depozitohen ne nje zone te caktuar nga Bashkia.

5.3 Llojet e ndikimeve kryesore ne mjedis dhe vleresimi i tyre

5.3.1. Ndikimet kryesore ne mjedis

Nga ndertimi dhe funksionimi i nje aktiviteti konsistojne ne vija te pergjithshme si me poshte:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat
- Shkarkimet ne uje
- Ndikimi ne toke
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e prodhuara
- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim ne çilesine e jetes ne qendrat e banuara
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor
- Ndikim ne peizazhin e zones
- Ndikim ne ndryshimet klimatike

Vleresimi i ndikimit ne mjedis i nje projekti te propozuar zhvillimi, eshte vleresimi i ndikimeve te rendesishme, te mundshme, te asaj veprimtarie ne mjedis. Gjate procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis kryhen identifikimi, pershkrimi dhe vleresimi ne menyren e duhur i ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie, te referuar ne paragrafin e mesiperm, duke percaktuar efektet e mundshme te drejtperdrejta dhe jo te drejtperdrejta mbi token, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimen, shendetin e njeriut, floren dhe faunen, peizazhin natyror, pasurite materiale, trashegimine kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre te ndersjellta.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis zbaton parimin e parandalimit qe ne fazen e hershme te planifikimit te projektit, me qellim shmangien apo minimizimin e efekteve negative ne mjedis, permes harmonizimit dhe pershtatjes se saj me kapacitetin bartes te mjedisit.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjese e pergatitjeve per planifikimin e nje projekti zhvillimi dhe para kerkimit te lejeve perkatese te zhvillimit. Ne baze te ketij vleresimi, institucioni pergjegjes per mjedisin, merr ne shqyrtim dhe kryen verifikimet perkatese per lejimin ose jo te zhvillimit te nje aktiviteti te caktuar. Institucioni pergjegjes per shqyrtimin e dokumentacionit dhe aprovimin ose jo te lejes mjedisore para vendimarrjes se tij, konsultohet edhe me institucione te tjera te cilat kane lidhe te drejteperdrejte ose jo te drejtperdrejte me projektin ose ndikohen nga ky i fundit. Konsultimi eshte edhe me i gjere me publikun e ndikuar dhe palet e interesit.

Nje pershkrim i shkurter per shkarkimet e mundshme ne mjedis:

- Shkarkimet ne mjedis nga zbatimi i ketij projekti, ne terma te shkurtuara do te ishte: Shkarkime ne ajer nga aktiviteti ndertimor. Pluhurat fluturues te kantierit te ndertimit, gazet e mjeteve te ndertimit dhe te transportit.
- Shkarkime ne ujera nga ujerat e shiut nga kantieri dhe ujerat e zeza nga aktiviteti gjate shfrytezimit te kompleksit.
- Shkarkimet e mbetjeve te ngurta, mbetjet urbane nga aktiviteti human dhe dheu qe do te largohet nga siperfaqja qe do te ndertohet.

- Zhurmat e punimeve ndertimore, nga mjetet e renda, nga transporti, por edhe gjate funksionimit nga aktivitetet me muzike ne oret e vona, nese do te zhvillohen.

5.3.2. Kohezgjatja e ndikimeve në mjedisin e zonës

Ndikimet kryesore kane qene gjate zbatimit te punimeve ndertimore .

- Siperfaqja e shtrirjes se ndikimit ne mjedis

- Ndikimi në mjedis ka qene vetem per zonen perreth kantierit te ndertimit, kjo deri ne nje perimeter rreth 200m rreth kantierit.
- Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe kthimi i mjedisit ne gjendjen e meparshme. Pas perfundimit te punimeve ndertimore, eshte bëre pastrimi dhe largimi I mbetjeve inerte qe kishin ngelur, gjelberimi ka qene pjese e projektit, por nuk siç nuk mund te pretendonim rikthim ne gjendjen e mepareshme te tokes, pasi kjo qender eshte projektuar per kete aktivitet per nje periudhe shume te gjate kohore.

5.3.3 Vleresimi i ndikimeve ne mjedis

***Ndikimet ne popullsi**

Vendi ku zhvillohet aktiviteti, ndodhet larg zonave te banuara, objekti nuk sjell shqetesime per banoret. Nga ngritja e aktivitetit nuk ka shpronesime dhe zhvendosje te popullsise.

***Ndikimet ne klime**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

***Ndikime ne flore e faune**

Objekti ku eshte instaluar impianti i GLN eshte ekzistues ai eshte ndertuar para viteve 2005 dhe instalacioni i impiantit ze nje siperfaqe te vogel. Si u pa edhe fizikisht, enkas eshte zgjedhur nje siperfaqe **ekzistente** dhe gjate ndertimit nuk ishin parashikuar prerja e ndonje peme. Gjithesesi ne çfaredo rasti, do të behej kerkese per heqje nga fondi pyjor apo kullosor. Nga ky aktivitet nuk do te vijne shqetesime si humbje te bimesise, prishje habitatesh, ekosistemesh etj.

***Ndikimet ne uje**

Duke qene se ndertimi i objektit ka ndikim vetem gjate fazes se ndertimit (maksimumi 90 dite) nuk ka shkarkime ne uje. Sic u tha me lart, do te behet terheqja e mbetjeve inerte sipas VKM ne fuqi. Po keshtu edhe per burimet nentokesore ky aktivitet nuk perben rrezik, pasi ky aktivitet nuk kerkon perdorim uji.

***Ndikimet ne toke**

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi humbje te tokes, rreshkitje te dherave, erosion etj. Asnje lloj mbetjeje nuk do shkarkohet ne toke. Mbetjet qe do te gjenerohen nga aktiviteti i pergjithshem i personelit apo ato te tipit ambalazh, shkon ne vendet e caktuara nga pushteti lokal.

***Ndikimet ne ajer**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk do te kemi emetime te gazeve te demshem apo te ererave te renda ne mjedisin perreth.

5.3.4 Ndikimet e pritshme ne mjedis nga zhvillimi i aktivitetit

Ndikimet e mundshme gjate fazes se funksionimit te aktivitetit mund te permblidhen sipas elementeve te mjedisit, si me poshte:

Ndikime ne toke

OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Instalimi	*Aktiviteti ne fjale eshte I ndertuar dhe ne funksion pasi eshte perdorur me pare nfa nje tjeter operator.*
Lëvizja e automjeteve të transportit	*Si pasojë e lëvizjes së makinerive:* *Mund të kemi rrjedhje aksidentale të lubrifikantëve nga ndonjë avari me pasojë ndotje të tokës.* *Mund te kemi rendim te trafikut rrugor.* ***Në raste të tilla do te pastrohet ne menyre te menjehershme zona, ndersa ne rastet e trafikut operatori operon ne perputhje me kondicionet urbane. Theksojme faktin se zona eshte urbane dhe shpeshhere me trafik te renduar. Mbushja e depopozites nga autobotet do te kryhet ne orare ku shmanget trafiku rrugor.***
Magazinim i lëndës së pare hidrokarbure/karburante	*Si rezultat mund te kemi emergjenca te ndryshme, zjarre etj.* ***Operatori kryen teste te papershkrueshmerise për pajisje nën presion nga subjekte te licençuara çdo 1 vit.***

Ndikime ne uje

OPERACIONI	PASOJA NË MJEDIS
Instalimi	*Shkarkimet ne ujera vijne nga:* *- Ujerat e ndotur higjenosanitare te ambjentit te stafit.* ***Kjo tipologji ndikimi eshte normal. Gjithashtu operatori perdor detergjente me permbajtje të ulet kimikatesh për të ruajtur cilsine e mjedisit ujor prites.***

	Ndikime ne biodiversitet
OPERACIONI	**PASOJA NË MJEDIS**
Instalimi	*Funksionimi i aktivitetit mund te shoqerohet me modifikim të pejsazhit ekzistues.*
	Për të minimizuar këte ndikim, operatori do te mbjelle fidane ne perimetrin rrethues te jashtem dhe te brendshem.

Ndikime ne ajer

OPERACIONI	***PASOJA NË MJEDIS***
Instalimi	*Si pasojë e lëvizjes së automjeteve do të gjenerohen:* - *zhurma,* - *pluhur,* - *gaze nga djegia e motoreve me djegie te brendshme.* ***Per keto ndikimi te analizuara operatori ka marre masa te ndryshme duke mos lejuar renien e burise ne ambjetet e furnzimit, duke shtruar me beton sheshin ne shfrytezim dhe duke detyruar mjetet per fikjen e tyre gjate momentit te furnzimit.***

Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille)

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit kufitar. Projekti nuk ndikon ne cenimin e sigurise se jetes dhe shendetit te shteve fqinje. Aktiviteti zhvillohet brenda territorit te vendit tone dhe nuk ka ndikime ne mjedisin nderkufitar.

6 - PROGRAMI I MONITORIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

6.1. Plani i Monitorimit Social e Mjedisor gjate funksionimit

Çeshtja	Masat	Pergjegjesia	Periudha
Pluhuri	*Eshte e nevojshme qe konsulenti te kryeje vezhgime vizuale te ngritjes se pluhurit gjate gjithe fazes se jetes se karburantit. Te gjitha aktivitetet, para fillimit te tyre, duhet t'i nenshtrohen nje vleresimi per mundesine e ngritjes se pluhurit. eshte me rendesi vezhgimi i kushteve te motit.*	*"GRAND OIL" Morave, Berat*	*Gjate gjithe fazes se fuksionimit* *(karburanti eshte ne fazen e shfrytezimit)*
Komunikimi	*Hapja dhe perditesimi i nje regjistri per regjistrimin e te gjitha komunikimeve lidhur me çeshtjet mjedisore dhe sociale, perfshire ankesat. Kjo do te arrihet nepermjet mekanizmit ekzistues te mbledhjes se ankesave.*	*"GRAND OIL" Morave, Berat*	*Gjate gjithe fazes se ndertimit*
Mbetjet	*Inspekti me vizuale te zonave te ruajtjes, grumbullimit dhe largimit te mbeturinave. Regjistrimet te behen ne baze te inspektimeve.*	*"GRAND OIL" Morave, Berat*	*Inspektime mujore. Marrja e masave parandaluese dhe korrigjuese, ne se eshte e nevojshme*
Mbetjet e lengshme	*Sigurimi se mbetjet jane menaxhuar ne menyren e duhur, bazuar ne kuadrin ligjor per kete qellim.*	*"GRAND OIL" Morave, Berat*	*Vazhdimisht gjate funksionimit te aktivitetit*
Ekologjia Tokesore	*Brez pemesh per te siguruar ndarjen Program edukativ mbi mjedisin. Monitorimi i levizjes se kafsheve ne rruget e hyrjes ne zone*	*"GRAND OIL" Morave, Berat*	*Gjate ndertimit dhe funksionimit te Kompleksit*
Ekologjia ujore	*Monitorimi i ujerave qe do te shkarkoje ne mjedis ky aktivitet. Monitorimi i objekteve te largimit te mbetjeve te ngurta e te lengshme ne toke*	*"GRAND OIL" Morave, Berat*	*Gjate funksionimit te karburantit*
Social- Ekonomike: Cilesia e jetes se punetoreve ne karburant*	*Pyetesor drejtuar punetoreve, vizita ne terren Ky pyetesor e do te realizohet nga nje specialist, i trajnuar e me pervoje ne standardet dhe çeshtjes e punes.*	*"GRAND OIL" Morave, Berat*	*Gjate funksionimit te karburantit*
Social-Ekonomike: Monitorimi i aspekteve shendetesore	*Identifikimi i treguesve dhe sigurimi i statistikave te shendetit te punetoreve*	*Doktori pergjegjes per punonjesit*	*Çdo muaj*

Monitorim i vazhdueshem i parametrave mjedisore (*Çlirimet në ajer, shkarkimet në uje dhe ne toke**]*	*Pajisjet e monitorimit dhe metodat do te jene ne perputhje me kerkesat kombetare shqiptare per kete aktivitet sipas VKM Nr. 1189, date 18.11.2009 "Per monitorimet" dhe ne kushtet e vena ne lejen mjedisore.*	*"GRAND OIL" Morave, Berat*	*Gjate fazes se shfrytezimit.*

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performance mjedisore të zbatimit të projektit.
Monitorimi i mjedisit është detyrim ligjor, mënyra, frekuenca dhe elementët e monitorimit janë të ndryshëm për veprimtari të ndryshme. Në vijim do të paraqesim elementët që duhet të monitorojë subjekti gjatë funksionimit të impiantit. Elementët e tjerë apo përcaktimi i frekuencave të monitorimit do të përcaktohet në akt miratimin e lejes mjedisore për këtë veprimtari.

- ***Plan kontrolli periodik***

Nr.	***Monitorimi***	***Parametrat që do të monitorohen***	***Frekuenca***	***Përgjegjësia***
1	*Cilësia e Ajrit*	*PM10,TSP,SO2, NOx, CO, CO2*	*Periodike*	*"GRAND OIL" Morave, Berat*
2	*Emetimi i zhurmave*	*Niveli i zhurmave në dB*	*Periodike*	*"GRAND OIL" Morave, Berat*
3	*Monitorim i zbatimit të kushteve të lejes mjedisore*	*Monitorim i kushteve dhe detyrimeve të përcaktura në aktmiratimin e lejes mjedisore*	*Periodike*	*"GRAND OIL" Morave, Berat*

7. PROGRAMI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE MONITORIMI I TREGUESVE TE MJEDISIT

Plani i Menaxhimit Mjedisor

Ky seksion perfshin pershkrimin e Planit te Menaxhimit Mjedisor (PMM) e projektit. Qellimi kryesor i PMM te siguroj ne proces te drejt gjate projektimit, ndertimit dhe operimit ne terma te impaktit dhe masave parandaluese te vleresuara ne Seksionin nr.6

PMM dhe Programi i Monitorimit Mjedisor do te jete ne formen e nje drafti ne menyre qe te siguroj implementimin e rekomandimeve parandaluese dhe te parandaloj te ndonje ndikimi te mundshme mjedisor te anashkaluar ne raportin e VNM-se

Pavaresisht nga kjo, PMM stimulon procedurat dhe rregullat qe duhet te ndiqen gjate ndertimit dhe per me shume gjate operimit te ketyre antenave. Plani i menaxhimit vleresohet ne tre faza kryesore.

Fazen e projektimit

Gjate kesaj faze eshte e rendesishme identifikimi i pronareve, faze kjo tashme e perfunduar ku te gjithe pronaret jane identifikuar dhe jane lidhur kontratat. Si dhe nje prej ideve kryesore eshte te shmanget konflikti midis mjedisit natyror dhe menaxhimit te tokes, ku dhe ky proces jane tashme te perfunduar me identifikimin e cdo site dhe realizimi i planimetrimeve perkatese per keto site.

Fazen e ndertimit

Punimet e nderimit per cdo site do te zbatohen nen mbikeqyrjen e supervizorit te percaktuar nga kontraktori.

Per te shmangur demtime apo nderhyrje ne zona te mbrojtura si trashegimi kulturore eshte e rendesishme qe te konsultohet me Institutin e Monumenteve te Kultures per te identifikuar zbulimet e raja qe nuk jane hedhur ne listen e zonave te trashegimise kulturore.

Plani i punes dhe i punimeve do te ndermeret nga kontraktori para se te filloj ne terren punimet specifike, bazuar ne kapacitetin e kontraktorit (numri i punonjesve, numri dhe cilesia e mjeteve dhe mekanizmave qe disponojne per kete proces). Punimet e ndertimit duhet te sistemohen dhe programohen ne menyre te tille qe te minimizojne ndikimin mbi mjedis.

Fazen e operimit

Ne lidhje me rrezatimin jonizues te linjave elektrike, intesiteti i fushes elektrike ne nje lartesi 1.8m nga siperfaqja e tokes,me nje varg telesh me lartesi te kalueshme , nuk e kalon 5 kV/m dhe me 1kV/m jashte zones buferike te sigurise, jo matje te tjera jane te nevojshme te realizohen per te mbrojtur mjedisin social dhe natyral te mjedisit, edhe pse keto jane pjese plotesuese te projektit kryesor.

Per kontenjeret qe jane pjese e cdo antene jane te pajisur me zjarre kontrollues, sistem ventilimi dhe gjenerator kur eshte e nevojshme, rrufe prites, dhe sinjali i paralajmerimit.

8. REKOMANDIME

- Te kryhet menaxhim i integruar i mbetjeve te ngurta duke i seleksionuar dhe menaxhuar nepermjet kontratave kontraktuale me Njesine e Qeverisjes Vendore ose subjekte te liçensuar per kete qellim.
- Te mos hidhet asnje mbetje e ngurte ose e lenget ne mjedisin ujor dhe ate tokesor te zones.
- Te kryhet monitorimi i treguesve mjedisor dhe raporti periodik i vetemonitorimit dhe te dorezohet ne DRM per periudhen e punimeve te ndertimit.
- Mirembajta dhe gjelberimi ne menyre te vazhduesheme i mjediseve perreth objekteve duke ruajtur nje imazh te kendshem dhe per rritjen e vlerave te rekreacionit te ketyre objekteve.
- Te rehabilitohet mjedisi i zones, duke mbjelle bime te larta ne perimetrin e kompleksit per te reduktuar impaktin vizual te kompleksit.
- Subjekti te jete ne dijeni te kuadrit ligjor per mjedisin dhe te ndryshimeve te tij

- Çertifikaten e specialistit/ëve qe ka hartuar raportin e thelluar te VNM-se

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 5215 Prot. Tiranë, më 23.06.2017

Nr. identifikues 521

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. EDMOND SINJARI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Lefter KOKA

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E MJEDISIT TIRANE

MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISE DHE SIPERMARRJES

OKB

Numri serial: LN-4125 11 2017
NUIS/NIPT: K62701004J

LICENCË

Subjekti: EDMOND SINJARI

Adresa: Berat, BERAT, Berat, BERAT, Lagja " 30 Vjetori ", bulevardi " Republika ", pallati nr.73, kati i peste, zona kadastrale nr.8502, me numer pasurie 14/23

Kodi: III.2.A (1+2)

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 21/11/2017

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtari të ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor dhe vlerësim i ndikimit në mjedis)

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Qarku: Berat, **Rrethi:** BERAT, **B/Ki:** Berat, **Q/P:** BERAT,
Adresa: Lagja " 30 Vjetori ", bulevardi " Republika ", pallati nr.73, kati i peste, zona kadastrale nr.8502, me numer pasurie 14/23

Irena Xoska

№ 1470

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale në Fushën e Studimit e Projektimit dhe Mbikëqyrje e Kolaudimit të Punimeve të Ndërtimit

LICENCË
T.0528/5

MBIEMRI	**SINJARI**
EMRI	**EDMOND**
ATËSIA	**MILTIADH**
DATËLINDJA	**23.10.1976, Berat**
VENDBANIMI	**BERAT**
DIPLLOMUAR, MË	**2002**
TITULLI	**Ing. Gjeodet**
DIPLLOMUAR, MË	**2018**
TITULLI	**Dizajn Urban dhe Peisazhi**
Regjistruar në Regjistrin profesional që nga data :	**26.06.2020**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË SEKRETARIA

NË PROJEKTIM			
Kat.	**2**	**d**	Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.
Kat.	**6**	**a**	Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
Kat.	**8**	**a**	Rilevime inxhinierike.
		b	Rilevime inxhinierike kadastrale.
		c	Sisteme GIS.
		d	Bazamente gjeodezike.
		e	Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

KRYETARI I KOMISIONIT

GERTA LUBONJA

Tabele fotografike

AUTOGAS


AUTOGAS

Edmond Sinjari

Digitally signed by Edmond Sinjari
Date: 2021.09.19 08:43:24 +02'00'